



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7900/2026
Data: 20.08.2026

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e shtatë -VII- për vitin 2026 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 28.07.2026 me fillim pune në ora 14:30 në sallën e takimeve. Prezent ishte Durim Dernjani (përfaqësues nga Drejtoria për Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Eventuale.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Kryesuesi thekson: a munden ende me u bërë legalizimet. Te drejtoria e urbanizmit krahasimi që është bërë për vitin 2026 inkasimi ishte shumë më i ulët. Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Durim Dernjani thekson: por ende është e hapur procedura dhe mund të bëhet. Kategoritë e dalura nga lufta janë të liruar prej taksës e cila është e paraparë me rregullore për taksa dhe tarifa. Ka filluar faza e dytë e ndërtimit të projektit të rrugës Gorancë-Krivenik që është financim i Ministrisë së Infrastrukturës kurse faza e parë është bërë prej komunës. Projektet e tjera nuk kanë filluar ende për shkak se zyra e prokurimit ka mbetur pa zyrtarë dhe është bërë marrëveshja me komunën e Ferizajt që me i zhvilluar procedurat. Po ashtu kemi pasur problem edhe me bartjen e buxhetit. Janë duke u realizuar projektet të cilat janë nisur në vitin e kaluar.

Erbllin Meliqi thekson: projektet të cilat janë zgjatur për shkak zyrës së prokurimit, a do të fillojnë në vitin 2026 apo do të barten në vitin 2027 pra bëhet fjalë për projektin për shtrimin me kupëza të betonit.

Durim Dernjani thekson: projekti për shtrimin me kupëza të betonit është duke u bërë por realisht është dashur me u bërë por kur është lidhur kontrata është lidhur për tre muaj dhe është lidhur me vonesë dhe nuk kanë mundur me përfunduar dhe disa rrugë kanë mbetur pa u kryer për shkak të kushteve klimatike se nuk kemi mundur me punuar në dimër dhe është dashur me u shtyjë deri në muajin maj e në muajin maj kemi pasur probleme me financa dhe me prokurim. Në vitin 2025 ka mundur me qenë shpronësimi që është bërë për autostradën dhe ekziston mundësia që në drejtorinë tonë inkasimi është më i ulët për shkak se diferencën e bëjnë ndërtimet e kategorisë së dytë dhe vitin e kaluar i kemi pasur dy leje të ndërtimit të kësaj kategorie.

Sead Vila thekson: mu dukë risi kjo pjesa e legalizimeve për lirim nga taksa për kategoritë e dalura nga lufta, drejtori a ka bërë ndonjë njoftim dhe prona a duhet të jetë patjetër në emër të veteranit apo familjarit të veteranit. Përveç rrugës Gorancë-Krivenik cilët janë tre projektet që priten të realizohen.

Durim Dernjani thekson: duhet me shikuar rregulloren dhe është mirë me shikuar rregullorja është në vebfaqe. Është lista e projekteve dhe lista e fundit që është bërë për bartje të mjeteve dhe projektet të cilat janë brenda asaj liste janë prioritare dhe do të realizohen.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk keni, kalojmë në pikën e radhës, të paraparë sipas agjendës.


3. Eventuale

Kryesuesi thekson: a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? nëse nuk keni shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në 14:48.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Komitetit
Basri Dernjani